



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0642

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare dhe Isa Hasani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së OE “EJONA” SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rregullimi dhe riparimi i ashensorëve” me numër të prokurimit 616-22-2435-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “Kuvendi I Komunës se Prishtinës”, më 08/12/2023, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e “EJONA” SH.P.K., me nr. 2023/0642 , e datës 01/09/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rregullimi dhe riparimi i ashensorëve”, me numër të prokurimit 616-22-2435-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “Kuvendi I Komunës se Prishtinës”. Ndërsa vendimi i AK-së te mbetet ne fuqi.

2. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 30.03.2023, “Kuvendi I Komunës se Prishtinës” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rregullimi dhe riparimi i ashensorëve” me numër të prokurimit 616-22-2435-2-1-1. Ndërsa me datën 11.08.2023 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues i cili ka shpërblyer me kontratë OE “Uplift” L.L.C

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës për shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 600,000.00€

Me 15.08.2023, OE "EJONA" SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 22.08.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 01.09.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "EJONA" SH.P.K., me nr. 642/23 lidhur me aktivitetin "Rregullimi dhe riparimi i ashensorëve" me numër të prokurimit 616-22-2435-2-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "EJONA" SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi Ankuesi pretendon se "1. Dhënia e kontratës OE "UP LIFT & INTRAST" SH.P.K shpie ne shkeljen e Nenit 26, pika 26.6. Ku secili anëtar nuk ka dëshmuar se i plotëson standardet përkatëse (ISO certifikatat).Pra, "UP Lift" si Lider i grupit nuk posedon Certifikatat për sigurimin e cilësisë, ashtu siç është kërkuar ne DT. AK duhet ta këtë parasysh se sipas Nenit 26, pika 26.6 secili anëtar i grupit do të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse.Po ashtu, e rikujtojmë AK se kushtet themelore të Rregullores (Mti) Nr. 05/2018 Për Sigurinë E Ashensorëve Në Përdorim , përkatësisht :Neni 5 Mirëmbajtësi i ashensorit. 2. Kualifikimi i mirëmbajtësit sigurohet me certifikatën e sistemit të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me standardin SK EN ISO 9001 versioni i fundit. Certifikata e sistemit të menaxhimit të cilësisë kërkohej një (1) vit pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore.Rrjedhimisht që nga viti 2019, mirëmbajtja dhe servisimi i ashensorëve ju lejohet Vetëm atyre kompanive qe janë te pajisura me ISO 9001.Pra, lideri i grupit qe parashihet ti kryej punimet ne këtë aktivitet, nuk është i licencuar me ISO 9001 për mirëmbajtjen e ashensorëve. Mirëpo, për te përmbushur kërkesën e AK, ka krijuar konzercium me OE "Intrast" i cili është i pajisur me ISO 9001, mirëpo kjo ISO nuk është për mirëmbajtjen/instalimin e ashensorëve.Vetëm me këtë fakt, AK do duhej ta eliminonte nga gara këtë OE, i cili nuk përmbush kritere për kualifikim.

Pretendimi Ankuesi pretendon se "2) OE i shpallur fitues ka dorëzuar Sigurimin e tenderit vetëm ne emër të liderit "UP Lift" por jo edhe te partnerit "INTRAST".Ani pse ka shfrytëzuar dokumentet e partnerit për ti përmbushur Kushtet e përshtatshmërisë, dhe ne këtë rast pasi partneri i grupit "INSTRAST" SHPK ka ofruar me se shumti dokumente për plotësimin e kushteve.

ia rikujtojmë AK se Sigurimi i Tenderit vlen për arsye të sigurisë se OE-te kanë dorëzuar dokumente legjitime dhe të vërteta. Andaj, sipas Nenit 57, sigurimi i tenderit është i domosdoshëm për të gjithë tenderuesit e jo vetëm për liderët e grupit.

Pretendimi (III) Ankuesi pretendon se “Neni 71 Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik - Deklarata nën Betim Grupi i OE "UP LIFT & INTRAST SHPK" & OE "HYMERI KLEEMANN" kanë shkelur Deklaratën nën betim, duke marrë pjesë në të njëjtin aktivitet si dy operatore të ndryshëm. Ku në fakt në certifikatat e biznesit të dorëzuara nga vete ata, figuron se personi i njëjtë (Bardh Hoti) është Drejtor në të dy kompanitë konkurruese në këtë aktivitet. Po ashtu, në dokumentacionin e OE të shpallur fitues kontratat e prezantuara janë me emal të OE tjetër pjesëmarrës Hymeri Kleemann. Si dhe për stafin kanë përdorur dokumentacion të njëjte. Me poshtë gjeni Certifikatën e Biznesit të dorëzuar nga OE "HYMERI LLC" ku si drejtor figuron i njëjti drejtor i OE tjetër pjesëmarrës "UP LIFT". Me poshtë gjeni kontratat e dorëzuara nga OE i shpallur fitues "UP LIFT", ku në këto dokumente figuron emali adresë e OE tjetër pjesëmarrës "HYMERI KLEEMANN". Iu rikujtojmë se OE "UP LIFT" ka përdorur këto dëshmi për të plotësuar kushtet në DT. Dëshmi këto të cilat do duhej të shpallehin të pavlefshme nga ana e AK DISPOZITA E SHKELUR 4) - Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve AK ka shkelur dispozitën e lartshënuar duke shpallur fitues një grup të OE të cilët nuk i përmbushin kërkesat në DT dhe të cilat kanë shkelur Deklaratën nën betim dhe kanë konflikt interesi në këtë aktivitet. DISPOZITA E SHKELUR 5) - Neni 5 Kalkulimi i afateve kohore, Neni 42 Njoftimi i Tenderuesve / Kandidatëve AK ka shkelur dispozitën e lartshënuar pasi që nuk ka respektuar afatet kohore duke shpallur Njoftimin për vendimin e AK ditën e premte 11.08.2023 në ora 16:02 (pas orarit të punës) AK po ashtu ka shkelur këtë dispozitë duke mos respektuar afatin kohor për Përgjigjen në Kërkesën për rishqyrtim, pasi që ka kthyer përgjigje 7 dite pas parashtrimit të kërkesës për Rishqyrtim, duke mos publikuar asnjë njoftim paraprak për zgjatjen e afatit të vlerësimit. DISPOZITA E SHKELUR 6) - Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, Neni 111 Arkivimi dhe Përmbajtja Thelbësore e Ankesës Jemi shumë të habitur me përgjigjen e AK sa i përket pretendimit tonë të shkeljeve serioze nga OE UP LIFT ku shihet qartë se këta dy OE konkurrent kanë përdorur dokumente të njëjta dhe drejtor i kompanive është i njëjti person, AK jep këtë përgjigje: Pra, edhe pse në kemi ofruar si dëshmi vetëm dokumentet e dorëzuara nga vete këtë OE pjesëmarrës (certifikatat e biznesit ku drejtor figuron i njëjti person, kontratat e të dy OE konkurrent ku si emali adresë e kontaktit është emali-i i njëjte), AK këtë pretendim tonin e quan tërësisht joserioz dhe joprofesional. Ndërsa në fakt vete përgjigja e AK në këtë pretendim është jo serioze dhe jo profesionale. Sepse në nuk kemi shpikur asgjë dhe nuk kemi dorëzuar fakte të rreme, por vetëm dokumente që këta dy OE me dëshirën e tyre kanë dorëzuar për plotësim të dokumentacionit të këtij aktiviteti. Pra, AK ka mbyllur sytë sa i përket këtyre shkeljeve si dhe gjetjet tona i quan jo serioze dhe jo profesionale.

Pretendimi (IV) Ankuesi pretendon se “Po ashtu, jemi shume te habitur me faktin se si jane marre parasysh Kërkesat për Rishqyrtim, por edhe ankesat e OSHP-pse nga ky grup i OE, kur te gjitha këto ankesa janë paraqitur vetëm ne emër te "UP LIFT" dhe asnjëherë ne emër te grupit te OE "UP LIFT & INTRAST SHPK". Për mendimin tone ankesat e këtij OE nuk do duhej te merreshin parasysh fare , e lere me të vonojnë një proces kaq të rëndësishëm tash e 1 vjet.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër, OE “EJONA” SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 26, 28, 71, 59, 5, 108/A, 111 të LPP-së. duke kërkuar nga Paneli Shqyrtues në OSHP që të aprovoni ankesën ton si te bazuar , të kthej lenden ne Rivlerësim dhe OE i shpallur fitues te shpallet i eliminuar për shkak te shkeljeve serioze te dokumentuara ne ketë ankesë

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 04/09/2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtuese për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 642/23, ndërsa me datë 14/09/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2023/0642 me rekomandimet si në vijim: “Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertit shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.”

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. *AK deklaroi se pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE ka deklaruar se NE “EJONA SHPK” Nuk pajtohem me Rekomandimin E Ekspertit 1)Citim nga ekspertiza: “Ekspertja shqyrtues fillimisht sqaron se neni 26.6 të cilit i referohet OE ankues vlen vetëm në rastet kur autoriteti kontraktues e përcakton në dosje të tenderit në mënyrë të prerë që secili prej anëtarëve të grupit duhet të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse. “Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit.. Në rastin konkret, kërkesa e sigurimit të tenderit bënë pjesë tek Gjendja Ekonomike dhe Financiare, neni 68 i LPP-së, përkatësisht tek paragrafi 1.2 evidencë të një police të sigurimit të lëshuar nga një kompani e njohur e licencuar e sigurimeve; EJONA përgjigja për ekspertizën: Vete ekspertja citon nenin ku thotë se çdo kërkesë sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 aplikohet ndaj grupit ne tërësi dhe jo ndaj secilit anëtarë. Ndërsa, ja rikujtojmë ekspertit se ISO Certifikatat bëjnë pjese tek “Neni 70 Standardet për Sigurimin e Cilësisë” Pra, sipas LPP aplikimi si grup ne tërësi nuk vlen për Nenin 70, por vetëm për 66.2, 68 dhe 69, si dhe pretendimi I ekspertit se ne cilën rubrike është vendosur kërkesa është shume jo serioz, pasi qe një rubrike nuk mund te jete mbi Ligjin e Prokurimit Publik. Andaj, ekspertiza ne lidhje me pretendimin tone se lideri I grupit nuk posedon certifikatat e cilësisë (te cilat kërkohen edhe sipas rregullores se MTI-se) nuk qëndron pasi qe Neni 70 vlen për secilin anëtarë individualisht dhe jo për grupin ne tërësi! Ku I bie se OE I shpallur fitues nuk ka përmbushur ketë kërkesë te DT dhe do duhej te eliminohej nga gara.*

2)Citim nga ekspertiza: Ekspertja shqyrtues sqaron se bazuar në shkresat e lëndës dhe pas hulumtimit në faqen zyrtare të ARBK-së për subjektet “Uplift” L.L.C dhe “Hymeri Elevators” L.L.C, sqaron se biznesi “Uplift L.L.C. është hapur/regjistruar me datë 01.09.2021 me

përfaqësues të autorizuar Bardh Hoti dhe Florid Neziraj, ku Florid Neziraj është edhe bashkëpronar. Kurse, sa i përket biznesit tjetër “Hymeri Kleemann”, në bazë të faqes zyrtare të ARBK-së, rezulton se është hapur/regjistruar me datë 27.09.2007, kurse me datë 12 Korrik 2018 bëhet aneks statuti i kësaj shoqërie tregtare duke i ndryshuar emrin në “Hymeri Elevators” L.L.C. Pra nga data 12 Korrik 2018 e tutje është “Hymeri Elevators”, me pronar drejtor menaxhues dhe përfaqësues të autorizuar z.Hysni Ymeri. Për tu kthyer të çështja e pretendimit ankimor se “Uplift L.L.C & Intrast” SHPK –Prishtinë dhe “Hymeri Kleemann” kanë shkelur deklaratën nën betim duke marr pjesë në të njëjtin aktivitet të prokurimit si dy operator ekonomik të ndryshëm”, ekspertja shqyrtuese sqaron se në bazë të rezultateve nga faqja zyrtare e ARBK-së këto dy subjekte janë dy entitete të ndara dhe personat e apostrofuat nga OE ankues nuk paraqiten si persona të autorizuar apo bashkëpronar në dy bizneset ashtu siç pretendon OE ankues. EJONA përgjigja për ekspertizën: Ekspertja e lendes pretendon se është bazuar në shkresat e lendes për vlerësimin e kësaj ankese, mirëpo bazuar në shkresat e lendes kemi të bëjmë me një situatë krejt tjetër nga ajo që ka pretenduar ekspertja. Bazuar në shkresat e lendes në kemi gjetur Certifikatat e biznesit të njëjtin pronar për dy OE që janë individualisht pjesëmarrës (OE Hymeri & OE UP LIFT). Po ashtu, kemi gjetur kontratat që OE “UP LIFT” që ka prezantuar si punë të kryera ku në ato kontrata shënon email adresë e OE tjetër pjesëmarrës (Hymeri). – vetëm bazuar në këto gjetje në shkresat e lendes ky OE do duhej të eliminohej nga gara dhe jo të mbrohej edhe nga ekspertja ligjore e cila nuk vlerëson lenden sipas shkresave të dorëzuara, por provon të bëjë hulumtime tjera në këtë rast në ARBK (te dhëna të cilat mund të ndryshohen për 30 minuta). Pra, ekspertja shqyrtuese ka bërë vlerësimin e kësaj ankese duke mos u bazuar në shkresat e lendes të dorëzuara nga vete këtë OE, duke shkelur Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve Ku thuhet se secila oferte duhet të vlerësohet në bazë të dokumenteve të dorëzuara para hapjes së tenderëve dhe ato plotësuese të lejuara sipas LPP, si dhe nuk lejohet ndryshimi i tyre. 3) Citim nga ekspertiza: Sa i përket pretendimeve se në dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë, kontratat e prezantuara janë me email të OE tjetër pjesëmarrës Hymeri Kleemann, dhe për stafin kanë përdorur dokumente të njëjta. Ekspertja shqyrtuese sqaron bazuar në dëshmitë e lëndës rezulton se disa nga referencat e stafit janë të lëshuara nga Hymeri Kleemann, por në anën tjetër duke u bazuar në dëshmitë e lëshuara nga Administrata Tatimore, konkretisht “Listën e pagave për të punësuar”, rezulton se disa punëtor ishin të deklaruar në ATK nga biznesi “Hymeri Kleman”, kurse me rastin e themelimit të biznesit “UP Lift”, këta punëtor kishin kaluar si të punësuar tek “Up Lift” sipas listës së pagave. Andaj, nuk paraqitet asnjë problem pse disa punëtor në të kaluarën kanë punuar në një kompani tjetër dhe tani vazhdojnë punën në kompani tjetër ose anasjelltas. EJONA përgjigja për ekspertizën: Këtu ekspertja ka bërë ndryshim thelbësor të pretendimit të tone duke ndryshuar kontekstin e gjithë pretendimit të tone. Pasi që pretendimi ynë ishte: “Me poshtë gjeni kontratat e dorëzuara nga OE i shpallur fitues “UP LIFT”, ku në këto dokumente figurojnë email adresë e OE tjetër pjesëmarrës “HYMERI KLEEMANN”. Iu rikujtojmë se OE “UP LIFT” ka përdorur këto dëshmi për të plotësuar kushtet në DT. Dëshmi këto të cilat do duhej të shpallehin të pavlefshme nga ana e AK.” Pra, në e kemi pasur fjalën për kontratat e dorëzuara nga OE “UP LIFT” për plotësimin e kriterit në DT: “1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme në vlerë minimale 400,000 euro në tri vitet e fundit duke filluar nga

data e publikimit te njoftimit per kontrate .” - OE I shpallur fitues (UP LIFT) ka dorëzuar kontrata ne te cilat figuron email adresa e OE tjetër pjesëmarrës “Hymeri” si emali zyrtar I kompanisë UP LIFT. Ndërsa, ekspertja shqyrtuese shtrembëron pretendimin tone duke japur mendim për stafin qe ka referenca nga OE Hymeri dhe jo për pretendimin tone. Kjo është e papranueshme për ne, qe te behet haptazi ndryshimi I pretendimit dhe ekspertiza te behet për një pretendim tjetër dhe jo për atë te cilin ne jemi ankuar. Rekomandimi i ekspertit shqyrtues qe ankesa te refuzohet si e pabazuar është totalisht i pa pranueshëm për ne! Andaj, me seriozitet te plote dhe kërkesë te sinqerte kërkojmë nga OSHP qe te behet vlerësimi i lendes bazuar ne shkresat e gjetura ne dokumentacionin e OE pjesëmarrës te cilat I kemi prezantuar ne ankese. Si dhe për këtë lende kërkojmë mbajtjen e seancës për shkak te shkeljeve serioze qe janë bere gjate kësaj procedure. e te kundërtën ne do te vazhdojmë me rruge tjera ligjore për zbardhjen e kësaj situate dhe ndalimin e keqpërdorimeve ne prokurimin publik. bashkangjitur gjeni edhe njëherë gjetjet ne dokumentet e dorëzuara nga dy OE pjesëmarrës “UP LIFT” & “HYMERI”.”

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertës, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Fillimisht Ekspertja shqyrtuese sqaron se kjo procedurë e prokurimit ka qenë objekt i shqyrtimit në OSHP, lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP-së, më **Nr. 2022/522** i dt:29.12.2022 dhe **2023/328** i dt:31.07.2023

Lidhur me pretendimet e OE “EJONA” SH.P.K.,ekspertja shqyrtuese përmes raportit nr. 2023/0642 ka vlerësuar si në vijim:

Ekspertja sqaron “*Sqarim hyrës: Autoriteti kontraktues Komuna e Prishtinës, për këtë aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, kontratë publike kornizë-shërbim me një operator ekonomik, Kohëzgjatja e kontratës publike kornizë 36 muaj, vlerë e madhe, Kriteret e Dhënies Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët të poentuar, vlera e parashikuar e kontratës 600,000.00€. Me qëllim të sqarimit të rrjedhës së këtij aktiviteti të prokurimit, në vijim do të japim një sqarim të shkurtër sipas kronologjisë së kësaj lënde. OE “Uplift L.L.C & Intrast” SHPK-Prishtinë (tani i rekomanduar për kontratë), ka parashtruar dy herë ankesë në OSHP, duke atakuar vendimin e AK Komuna e Prishtinës, me arsyetimin se është eliminuar pa të drejt nga ana e AK-së, duke pretenduar se i plotëson kriteret e dosjes se tenderit dhe oferta e tij është ofertë e përgjegjshme me çmimin më të lirë. Pra, kjo procedurë e prokurimit ka qenë objekt i shqyrtimit në OSHP, me ç’rast është nxjerr raporti i ekspertizës me nr.522-2022 dhe nr.328-2023. Po ashtu, edhe Paneli Shqyrtues nxjerr Vendimin PSH.nr.522/2022 të datës 29.12.2022 dhe PSH.nr.328/2023 të datës 31.07.2023. AK Komuna e Prishtinës pas vendimit PSH.nr.328/2023, të datës 31.07.2023, ka bërë rivlerësimin e ofertave dhe me datë 11.08.2023*

ka nxjerr B58 Njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues duke rekomanduar për kontratë grupin e operatorëve ekonomik “Uplift L.L.C & Intrast” SHPK –Prishtinë. I pa kënaqur me këtë njoftim, OE ankues “Ejona” shpk paraqet kërkesë për rishqyrtim tek AK, ku AK përmes vendimit të datës 22.08.2023, ka refuzuar kërkesën për ri shqyrtim si të pa bazuar të OE ankues. Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, kundrejt pretendimeve ankimore OE ankues “EJONA” SHPK -Pejë, sqarojmë se OE ankues pretendon se AK- Komuna e Prishtinës, ka vepruar në kundërshtim me paragrafin 6 të nenit 26 të LPP-së, paragrafin 1 dhe 3 të nenit 28, nenin 71, nenin 59.4, nenin 5, nenin 42 dhe 108/A të LPP-së, ku këto pretendime ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratë.”

Pretendimi i parë (I) ekspertja sqaron se “Përgjigje në pretendimet ankimore (Neni 113 LPP) “EJONA” SHPK -Pejë, Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues, se në bazë të nenit 26, pika 26.6, secili anëtar i grupit duhet të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse në lidhje me certifikatat e sigurisë, ku UP Lift si lider i grupit nuk posedon certifikatat për sigurimin e cilësisë. Ekspertja shqyrtues fillimisht sqaron se neni 26.6 të cilit i referohet OE ankues vlen vetëm në rastet kur autoriteti kontraktues e përcakton në dosje të tenderit në mënyrë të prerë që secili prej anëtarëve të grupit duhet të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse. Për më tepër, kjo dispozitë që i referohet OE ankues përcakton “Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon certifikata të hartuara nga organe të pavarura...”, sipas kësaj dispozite ligjore, AK-së i lejohet që të vendos NËSE kërkon që secili prej anëtarëve duhet të përmbush këto standarde përkatëse, ku në rastin konkret AK nuk e ka kërkuar një gjet të tillë. Për më tepër, ekspertja shqyrtuese sqaron se neni 71, par. 4 i LPP-së përcakton se çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të LPP-së do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit. Në rastin konkret, kërkesa e vendosur në dosje të tenderit “3.Operatori duhet te jete i çertifikuar sipas standardeve ISO 9001 , ISO 14001 dhe ISO 18001” bënë pjesë të mundësitë teknike dhe/ose profesionale, e cila kërkesë buron nga neni 69 i LPP-së. Sa i përket pikës ankimore të OE ankues në lidhje me Rregulloren MTI Nr.05/2018 Për Sigurinë e Ashensorëve në Përdorim, neni 5 (Mirëmbajtësi i ashensorit), ekspertja shqyrtuese sqaron se sipas dosjes së tenderit, kjo rregullore të cilës i referohet OE ankues nuk është kriter vlerësues pasi që në dosje të tenderit askund nuk është cekur/kërkuar kjo rregullore. Nëse kjo rregullore paraqet ndonjë rëndësi për sigurinë e ashensorëve, është përgjegjësi e zyrtarëve kompetent pranë AK-së që gjatë përpilimit të dosjes së tenderit të caktojnë kriteret apo kërkesa që nuk cenojnë sigurinë e përdoruesve. Në anën tjetër, duke pasur parasysh nenin 56.3 të LPP-së, është e ndaluar që të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura tenderuesi në bazë të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Pretendimi i dytë (II) ekspertja sqaron se “Lidhur me pretendimin ankimor, se GOE të rekomanduar për kontratë “Uplift L.L.C & Intrast” SHPK –Prishtinë, ka dorëzuar sigurimin e tenderit vetëm në emër të liderit “Up Lift” por jo edhe të anëtarit tjetër të grupit “Intrast”, ku secili nga anëtarët e grupit të operatorëve ekonomik do duhet të depononte nga një policë të sigurimeve, ekspertja shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor është i pa bazuar për faktin se nuk është kërkuar që sigurimi i tenderit të bëhet nga të gjithë anëtarët e konsorciumit/grupit. Po

ashtu, dispozita ligjore e LPP-së, përkatësisht paragrafi 4 i nenit 71 të LPP-së ka përcaktuar: “Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik, secili anëtar i grupit është i obliguar të dëshmojë ose konfirmojë në përpunje me nenin 67 të këtij ligji, se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në aktivitetin e prokurimit sipas nenit 65 të këtij ligji. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit. Në rastin konkret, kërkesa e sigurimit të tenderit bënë pjesë tek Gjendja Ekonomike dhe Financiare, neni 68 i LPP-së, përkatësisht tek paragrafi 1.2 evidencë të një police të sigurimit të lëshuar nga një kompani e njohur e licencuar e sigurimeve;”

Pretendimi i tretë (III) ekspertja sqaron se “Lidhur me pretendimin tjetër ankimor, se grupi i operatoreve ekonomik “Uplift L.L.C & Intrast” SHPK –Prishtinë dhe “Hymeri Kleemann” kanë shkelur deklaratën nën betim duke marr pjesë në të njëjtin aktivitet të prokurimit si dy operator ekonomik të ndryshëm. Tutje OE potencon se certifikata e biznesit të dorëzuara nga vet ata figuron se personi i njëjtë (Bardh Hoti) është drejtor në të dy kompanitë konkurruese në këtë aktivitet të prokurimit. Po ashtu në dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë, kontratat e prezantuara janë me e-mail të OE tjetër pjesëmarrës Hymeri Kleemann, dhe për stafin kanë përdorur dokumente të njëjta. Ekspertja shqyrtues sqaron se bazuar në shkresat e lëndës dhe pas hulumtimit në faqen zyrtare të ARBK-së për subjektet “Uplift” L.L.C dhe “Hymeri Elevators” L.L.C, sqaron se biznesi “Uplift L.L.C. është hapur/regjistruar me datë 01.09.2021 me përfaqësues të autorizuar Bardh Hoti dhe Florid Neziraj, ku Florid Neziraj është edhe bashkëpronar. Kurse, sa i përket biznesit tjetër “Hymeri Kleemann”, në bazë të faqes zyrtare të ARBK-së, rezulton se është hapur/regjistruar me datë 27.09.2007, kurse me datë 12 Korrik 2018 bëhet aneks statuti i kësaj shoqërie tregtare duke i ndryshuar emrin në “Hymeri Elevators” L.L.C. Pra nga data 12 Korrik 2018 e tutje është “Hymeri Elevators”, me pronar drejtor menaxhues dhe përfaqësues të autorizuar z.Hysni Ymeri. Për tu kthyer të çështja e pretendimit ankimor se “Uplift L.L.C & Intrast” SHPK –Prishtinë dhe “Hymeri Kleemann” kanë shkelur deklaratën nën betim duke marr pjesë në të njëjtin aktivitet të prokurimit si dy operator ekonomik të ndryshëm”, ekspertja shqyrtuese sqaron se në bazë të rezultateve nga faqja zyrtare e ARBK-së këto dy subjekte janë dy entitete të ndara dhe personat e apostrofuara nga OE ankues nuk paraqiten si persona të autorizuar apo bashkëpronar në dy bizneset ashtu siç pretendon OE ankues”.

Pretendimi i katër (IV) ekspertja sqaron “Sa i përket pretendimeve se në dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë, kontratat e prezantuara janë me email të OE tjetër pjesëmarrës Hymeri Kleemann, dhe për stafin kanë përdorur dokumente të njëjta. **Ekspertja shqyrtuese** sqaron bazuar në dëshmitë e lëndës rezulton se disa nga referencat e stafit janë të lëshuara nga Hymeri Kleemann, por në anën tjetër duke u bazuar në dëshmitë e lëshuara nga Administrata Tatimore, konkretisht “Listën e pagave për të punësuar”, rezulton se disa punëtor ishin të deklaruar në ATK nga biznesi “Hymeri Kleman”, kurse me rastin e themelimit të biznesit “UP Lift”, këta punëtor kishin kaluar si të punësuar tek “Up Lift” sipas listës së pagave. Andaj, nuk paraqitet asnjë problem pse disa punëtor në të kaluarën kanë punuar në një kompani tjetër dhe tani vazhdojnë punën në kompani tjetër ose anasjelltas.Lidhur me pretendim ankimor se

kërkesat për rishqyrtim po ashtu edhe ankesat në OSHP-së, janë paraqitur vetëm në emër të OE UP Lift dhe asnjëherë në emër të grupit “Uplift L.L.C & Intrast” SHPK ku ankesa e të njëjtit nuk është dashtë të merret fare në shqyrtim. Ekspertja shqyrtuese sqaron se bazuar në shkresat e lëndës marrëveshjen e grupit deklaratën liderit si dhe deklaratën e autorizimit rezulton se lideri i grupit është OE “Uplifte”. Andaj i njëjti ka të drejtë të përfaqëson dhe nënshkruaj në emër të grupit të operatoreve ekonomik. Andaj pretendim ankimor është i paqëndrueshëm. Sa i përket pretendimit ankimore se AK nuk ka respektuar afatet kohore duke shpallur njoftimin për vendim e AK ditën e premte 11.08.2023 në ora 16:02 (dy minuta pas orarit të punës) konkretisht AK ka shkelur nenin 5 dhe 42 të LPP-së, ku të njëjtit kanë kthyer përgjigje ndaj kërkesë për rishqyrtim 7 (shtatë) ditë pas parashtrimit të kërkesës. Ekspertja shqyrtuese sqaron se neni 5 i LPP-së, përcakton afatet ligjore ku fillojnë në një ditë pune dhe përfundojnë në një ditë pune. Në rastin konkret data 11.08.2023, ka qenë ditë pune, sa i përket asaj se ka publikuar vendimin në ora 16:02 (pas orarit të punës) konsideroj se kjo çështje është krejtësisht teknike dhe nuk ka ndikim në rezultatin e këtij aktiviteti të prokurimit, ndërsa sa i përket vonesës prej dy ditëve të përgjigjes ndaj kërkesë për rishqyrtim ekspertja shqyrtuese sqaron se AK ka nxjerr vendim ndaj kërkesë për rishqyrtim me datën 22.08.2023 konform nenit 108/A të LPP-së duke i arsyetuar pretendimet e parashtruesit të ankesës, por nuk ka informuar ankuesin për zgjatjen e afatit shtesë ashtu siç parasheh pika 6 e nenit 108/A të LPP-së “Autoriteti kontraktues do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informative shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në paragrafin 5 të këtij neni. Afati i përmendur më lart, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë.”

Sipas të thënave më sipër, ekspertja shqyrtuese i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE “EJONA” SH.P.K., Argumentimi në raportin e ekspertës shqyrtuese është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin raportit të ekspertës shqyrtuese. Me këtë rast Paneli Shqyrtues ka marrë në konsideratë edhe përgjigjen e dhënë nga OE ankues. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “EJONA” SH.P.K., janë të pa bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përdërisa parashtruesat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore. Në këtë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse Ankesat në këtë rast.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertës shqyrtuese dhe mendimi i saj janë të pranueshme dhe se Paneli me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurim publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit të lartcekur . Sipas të dhënave me sipër ekspertja i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues “EJONA” SH.P.K., argumentimi në raportin e ekspertës është mjaft i detajuar i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen këtij aktivitetit të prokurimit . Andaj Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plot të gjendjes faktike duke u mbështetur në LPP si ligj material i zbatueshëm dhe rekomandimin e ekspertës ka gjetur se ankesa e OE “EJONA” SH.P.K., duhet të refuzohet si e pa bazuar . Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur që të vërtetohet Njoftimi mbi vendimin e AK B58 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rregullimi dhe riparimi i ashensorëve” me nr. të prokurimit: "616-22-2435-2-1-1". Vlenë të theksohet fakti se njoftimi për kontratë për këtë aktivitet të prokurimit është publikuar më dt. 30.03.2022 dhe në këtë kohë në fuqi ka qenë RRUOPP, ndërsa Rregullorja për Prokurim Publik nr. 001/2022, ka hyrë në fuqi më dt. 01.11.2022 dhe dispozitat e e kësaj rregullorje konkretisht neni 26.6 për të cilën ka aluduar ankuesi në këtë rast vlenë vetëm për aktivitetet e prokurimit të cilat janë iniciuar pas hyrjes në fuqi të kësaj rregullorjeje.

- Përfundim -

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 59 dhe 62 të LPP, të cituara në Ankesë. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast nuk përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit

në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - " EJONA " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: